

Porosi selefi dhe këshilla edukative

Ahmed ibn Umer Bazmul

Porosi selefije dhe këshilla edukative

Ahmed ibën Umer Bazmul

www.forumiselefi.net

Titulli:

Porosi selefije dhe këshilla edukative

Autori:

Ahmed ibën Umer Bazmul

Përktheu:

Besmir I. Cacani

Kontrollloi:

Xhemal N. Jakupi

Burimi:

<http://www.ajurry.com/vb/showthread.php?t=35239>

*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit.*

Lavdia i qoftë Allahut, Atë e lavdërojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e vetëve dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush e humbet, ndërsa atë që Allahu e humbet, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të pashok, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. Fjala më e vërtetë është Fjala e Allahut, ndërsa udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit. Punët më të këqija janë ato të shpikura, ku çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje është në Zjarr. Më pas:

Prej mirësive të Allahut *azze ue xhel-le* mbi mua dhe ju të gjithë, është se na ka bërë prej pjesëtarëve në Fenë madhështore Islame. [na ka bërë prej të pjesëtarëve] në Fenë Islame, me të cilën Allahu *azze ue xhel-le* ka mbyllur shpalljet, ndërsa Pejgamberi ynë Muhamed *sal-lAllahu*

alejhi ue sel-lem ka mbyllur dhe vulosur Pejgamberët dhe pejgamberinë; nuk ka pejgamber pas tij *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe ai është vula *alejhis-salatu ues-salam*. Kjo Fe madhështore me të gjitha ligjet dhe me të gjitha dispozitat e saj, ka përfshirë atë që përmban lumturinë për njerëzit në këtë dynja dhe në Ahiret; kjo nëse njerëzit e praktikojnë, i kryejnë, i zbatojnë urdhëresat e saj dhe largohen nga të ndaluarat.

Unë po flas me ju – Allahu ju begatoftë – nga pikënisja e udhëzimeve Islame dhe porosive pejgamberike, dhe **gjëja e parë që ju porosis** është ajo e Ikhlasit (përkushtimit) ndaj Allahut *aẓẓe ue xhel-le*: pra qëllimi yt nga veprat të jetë Fytyra e Allahut, dhe jo të jetë filani nga mesi i njerëzve si syfaqësi, apo si kërkim i famës apo si kërkim i një pozite dynjaje.

Përkushtimi i veprës për Allahun *aẓẓe ue xhel-le* ka shumë argumente.

“Vërtetë veprat vlerësohen sipas qëllimit, dhe çdo njeri shpërblehet me atë që ka patur për qëllim.” [Muttefekun alejhi].

“E kush shpreson takimin e Zotit të tij, atëherë le të punojë vepra të mira, dhe mos t’i bëjë ortak (apo të barabartë) Zotit të tij asgjë (dhe askënd).” [elKehf: 110].

Pra, vepra e përkushtuar dhe me Ikhlas – sikurse përmendëm – ka shumë dhe shumë argumente. Mirëpo, dijetarët tërheqin vëmendje drejt frytit të këtij përkushtimi, i cili është se njeriu e shpreson shpërblimin nga Allahu *aẓẓe ue xhel-le*, dhe i duron ato vështirësi që i has gjatë rrugës së thirrjes për tek Allahu, dhe gjatë rrugës së ruajtjes së unitetit Selefi nga ndarjet dhe përçarjet. Sa e sa vuajnë selefitë nga disa prej vëllezërve të

tyre që nuk janë të durueshëm, të cilët hakmerren për vetet e tyre dhe nuk shpresojnë shpërblimin nga Allahu *aẓẓe ue xhel-le*.

Unë porosis veten dhe ju porosis të gjithë juve, që t’i japim përparësi interesit të kësaj Feje, interesit të këtij Menhexhi Selefi dhe interesit të vëllezërve tanë selefi përpara interesit tonë [personal]. Mos të hakmerremi për vetet tona me gjëra që mund të nxisin inatin

dhe urrejtjen mes selefive. Me fjalët e mia kam për qëllim inatin dhe urrejtjen në çështjet e dynjasë, dhe për inatin dhe urrejtjen mes vëllezërve selefij, dhe nuk kam për qëllim përgjithësimin; e më pas të ngatërrohen gjërat.

Nëse disa prej vëllezërve tanë bien në kundravajtje, kjo *insha Allah* është një çështje që do të trajtohet. Nëse bien në kundërvajtje sheriatike, kjo çështje do të trajtohet ç'ka rreth saj, *insha Allah*. Pra së pari përkushtimi (Ikhlas), që përfshin durimin, përfshin besnikërinë dhe përfshinë çështje të shumta.

Çështja e dytë me të cilën porosis veten dhe ju pas [çështjes] së përkushtimit (Ikhlasit), është ajo e Takuasë (frikës) ndaj Allahut *azze ue xhel-le*. [porosis për] frikë ndaj Allahut lidhur me mbikqyrjen e Tij *subhanehu ue teala*, sepse ndonjëri prej jush mund të thotë një fjalë apo të veprojë ndonjë vepër ku shfaq të kundërtën e asaj që fsheh. Vërtetë ai që shfaq të kundërtën e asaj që fsheh, nëse mund të mashtrojë njerëzit, atëherë ai nuk mund të mashtrojë Allahun, sepse Allahu e di të fshehtën.

Frika ndaj Allahut *azze ue xhel-le* do të thotë [të ndjerit] mbikqyrjen e Tij *subhanehu ue teala*, dhe do të thotë që njeriu të

njohë me çfarë të mbrohet [nga Zjarri] e më pas të ruhet. Frika (Takuaja) ndaj Allahut gjithashtu të dërgon drejt durimit, të dërgon drejt mbrojtjes së interesit të Menhexhit Selefi, interesit të vëllezërve tanë selefi, durimin e tyre, mos shkaktimi i ndonjë veprimi që dërgon në ndarje dhe përçarje, jo për interes të Menhexhit Selefi, por për interesin tonë me imazhin e mbrojtjes së Menhexhit, e kjo do të vijë më vonë *in sha Allah*.

Çështja e tretë për të cilën porosis veten dhe vëllezërit e mi, pas përkushtimit (Ikhlasit) dhe pas Takuasë, i porosis për sinqeritet.

“O ju të cilët keni besuar! Jini të devotshëm ndaj Allahut dhe qëndroni me të sinqertët!” [et-Teubeh: 119]. Sinqeriteti është që e dukshmja të përputhet me të padukshmen, dhe të jetë muslimani këshillues i vëllezërve të tij, i sinqertë me ta në marrdhënie dhe mos t'i mashtrojë. Mos t'i shfaqë atyre diçka që është

në kundërshtim me të padukshmen; vërtetë sinjeriteti është prej shenjave më të spikatura të selefive besnikë. Ata nuk kanë mashtrime, nuk kanë të fshehta, urdhërojnë për mirë, ndalojnë nga e keqja dhe janë të singertë ndaj njerëzve në fjalët dhe veprat e tyre.

Çështja e katërt me të cilën ju porosis ju dhe veten, është mosndarja nga dijetarët e mëdhenj selefi, rikthimi tek fetvatë e tyre, tek kasetat e tyre, tek librat e tyre, leximi i atyre librave,

studimi dhe përfitimi prej atyre librave; sepse rikthimi tek dijetarët e mëdhenj selefi, është prej bazave të rëndësishme Selefije. Gjithashtu me rikthimin tek dijetarët selefi, duhet patur kujdes lidhur me respektimin e tyre, vlersimin e tyre, dashurinë e tyre dhe të larguarit nga mungesa e edukatës me ta.

Dijetarët e mëdhenj janë të njohur për çdo selefi, si psh: shejh Ibën Bazi, Ibën Uthejmini, Albani, Allahu i mëshiroftë të gjithë. Poashtu shembull është: shejh en-Nexhmi (Allahu e mëshiroftë), Muhamed Eman el Xhami (Allahu

e mëshiroftë), gjithashtu si shembulli i shejh Rabia el Medkhali, shembulli i shejh Feuzanit, shembulli i shejh Zejd el Medkhali, si shembulli i shejh Ubejd el Xhabiri (Allahu i ruajtë) dhe të tjerë dijetarë selefi të njohur. Vërtetë rikthimi tek këta dijetarë selefi dhe ndjekja e udhëzimit të tyre, të Sunetit të tyre dhe ecja me mendimet dhe fjalët e tyre në udhëzimet që i drejtojnë rinisë, [vërtetë] kjo është një çështje me rëndësi.

Gjithashtu prej gjërave që porosis është edhe nxënia e diturisë, dhe mësimi i gjërave që ndonjëri prej nesh ka nevojë gjatë ditës dhe natës, ku më e rëndësishmja është 'Teuhidi dhe çfarë lidhet me të, njohja e shirkut që është e kundërta e 'Teuhidit. Pra, secili prej nesh i mëson këto çështje, mëson çfarë lidhet me pastërtinë e tij, namazin e tij, agjërimin e tij, me haxhin e tij nëse dëshiron të bëjë haxhin dhe lidhur me zekatin e tij nëse ka pasuri.

Kërkimi i diturisë është farz ajn dhe farz kifaje. Dituria që është detyrë [për çdo individ], është ajo dije që muslimani dhe

muslimania kanë nevojë lidhur me

adhurimin e Zotit të tyre, ndërsa [ditura] që është farz kifaje, është [ditura] shtesë mbi të parën.

Ditura e përmirëson sjelljen, bën që njeriu të sillet në mënyrë të rregullt dhe bën që t'i kuptojë pasojat e çështjeve. Për këtë arsye, ajo që ankojmë prej disa të rinjve selefi dhe prej sjelljes së tyre të keqe në disa raste; vërejmë se në shumicën e rasteve shkak i kësaj gjëje i rikthehet injorancës dhe mosnjohjes së Fesë së Allahut *azze ue xhel-le*.

Kur ne porosisim për dituri, së pari me këtë porosi kemi për qëllim diturinë që muslimani ka nevojë lidhur me adhurimin e Zotit të tij.

Ditura.. ia përmirson sjelljen njeriut; vërtetë kush e ndjek dhe e mëson Menhexhin Selefi, domosdoshëm që sjellja e tij do të jetë e mirë. Me këto fjalë të mia nuk kam për qëllim të bëj ndarje mes sjelljes (edukatës) dhe Menhexhit; sepse sjellja e keqe prej disa selefivë vjen si shkak i injorancës, dhe jo si shkak i vetë Menhexhit Selefi; kush e praktikon (dhe zbaton) Menhexhin Selefi, sjellja e tij

përmirsohet.

Ndërsa ata që mundohen të bëjnë ndarje mes Menhexhit dhe sjelljes (edukatës) – sikur Menhexhi të jetë diçka dhe sjellja diçka tjetër -, ky nuk e kupton esencën dhe realitetin e Menhexhit Selefi. Vërtetë nëse ai do ta kuptonte esencën dhe realitetin e Menhexhit Selefi, do ta kuptonte se ky Menhexh ngrihet mbi edukatë.

Pra, nëse ju është bërë kjo e qartë, atëherë keni kuptuar – Allahu ju begatoftë - , se Menhexhi Selefi i përmirson sjelljet e pasuesve të tij, dhe i drejton drejt asaj që është më e mirë. Pra Menhexhi sikurse e thamë, kush e mëson dhe e praktikon, sjellja e tij përmirsohet.

Unë e përsëris se disa që përpiqen t'i cilësojnë se selefitë kanë edukatë të keqe, kjo është një përpjekje e dështuar.

Porosia pasardhëse: porosis veten dhe ju për vllazëri, për ruajtje të vëllezërve selefi, për durimin e tyre dhe këshillimin e tyre; sepse vërtetë Feja është përkushtim: për Allahun, për

Pejgamberin e Tij, Librin e Tij, për prijësit muslimanë dhe masën e gjërë të tyre. Vëllezërit tanë selefi bëjnë pjesë tek masa e gjërë e muslimanëve. Përkushtimi ndaj tyre do të thotë porositja e tyre, besnikëria në marrdhënie, dashja e të mirës për ta sikurse e dëshiron për veten, këshillimi i tyre për atë që është më e mirë nëse gabojnë, zelli (dhe përpjekja) për udhëzimin e tyre, mos të veprosh ndonjë veprim që tregon se po ngre kurth, po mashtron apo po e fsheh, mos t'u ngresh atyre pritë, të përpiqesh t'i këshillosh ata, tërheqja e vërejtjes së tyre drejt të mirës përderisa ai është vëllai yt selefi dhe ka rënë në këto çështje gabimisht dhe pa qëllim, apo ka rënë me qëllim si shkak se është mashtruar nga shejtani; këtu nuk ka ndonjë problem që të këshillohet dhe të përpiqesh ta udhëzosh.

Ky është një kapitull i rëndësishëm që duhet kuptuar nga selefiu, sepse ne vërejmë nga disa prej vëllezërve tanë selefi që mendon se çdokush që bie në ndonjë kundravajtje në Menhexh

nga mesi i vëllezërve të tij selefi, mendon se është i humbur dhe që i humb të tjerët, [dhe mendon] se ai e meriton te refuzohet dhe paralajmërohet prej tij. Ky është pikërisht Menhexhi i Haddadive prej të cilit kanë paralajmëruar dijetarët. Ka dallim mes paralajmërimit që dijetarët bëjnë nga kundërshtarët dhe mes këtij veprimi. Dallimi është se dijetarët i këshillojnë ata, i sqarojnë, i durojnë derisa të arrijnë në një gradë ku vërejnë se ata nuk e duan të vërtetën; atëherë paralajmërojnë prej tyre, apo [paralajmërojnë] nëse arrijnë në një gradë ku e keqja e tyre është përhapur, ama të jenë ata nismëtarët, jo, kjo nuk ndodh.

Ndoshta disa prej vëllezërve tanë selefi kanë vërejtur të tilla veprime dhe kanë menduar se dijetarët paralajmërojnë pa kushtëzime, se ata nuk bëjnë durim ndaj kundërshtarëve; e kjo është gabim. Nëse disa prej vëllezërve tanë bien në gabim, atëherë ne i këshillojmë ata, i porosisim dhe përpiqemi në udhëzimin e tyre; ndoshta Allahu i jep dobi nga kjo. Ne bëjmë durim derisa t'ia sqarojmë atij të vërtetën, e

kështu i kemi vërejtur dijetarët tanë: shejh Rabinë, shejh Ubejdin, shejh Nexhmin etj. Mos mendoni –Allahu ju begatofte – se kur dijetarët i refuzojnë kundërshtarët, [mos mendoni] se ata i refuzojnë menjëherë pa i pritur, thjeshtë me një kundravajtje.. jo, jo, ky është një mendim i gabuar.

Pasha Allahun! Nuk ka person prej të cilit kanë paralajmëruar dijetarët prej tij, vetëm se gjëndja e tij e keqe është bërë e qartë, është bërë i qartë mospranimi i tij për të vërtetën, kokëfortësia e tij dhe nuk kam nevojë që t'ju jap shembull për këtë çështje. Shejhu ynë, imami dhe bartësi i flamurit të Xherhut dhe Ta'dilit; Rabia el Medkhali (Allahu e ruajtë), është prej dijetarëve më të spikatur në këtë kohë që i duron kundërshtarët dhe që përpiqet t'i udhëzojë ata. Përkundrazi, po ju them një çështje prej menhexhit të tij që e kam vërejtur, se ai nganjëherë e tejkalon dhe mbyll një sy ndaj kundërshtarit nëse ai shfaq se është penduar. Ai i jep kohë se ndoshta është besnik në këtë çështje megjithëse vërehet kokëfortësia e tij, mirëpo thotë se ndoshta i bën dobi. Deri në

këtë pikë duron shejhu.

Allahu ia shpërbleftë me të mira, kur ai flet, kundërshtari më pas –sikurse e dini – bie poshtë plotësisht, dhe nuk është nevoja që ai të hidhet poshtë një herë tjetër; sepse shejhu – *subhanAllah* përmes durimit të tij – ia ka prerë arsyetimet.

Vëllezër të mi – Allahu ju begatoftë – të gjithë gabojmë, të gjithë mund të biem në gabim, dhe rënia e disa prej nesh në tilla gabime, nuk do të thotë që t’i kundërvihemi atij, apo ta cilësojmë si haddadi, apo ta cilësojmë me tilla gjëja, mirëpo “ndreqim ose përpiqemi të ndreqim”, përpiqemi të rregullojmë dhe përpiqemi të jemi të mirë me vëllezërit tanë.

Poashtu prej fjalëve të bukura të shejh Rabisë në këtë tëmë, thotë se disa selefi gëzohen me rënien e vëllezërve të tij, dhe nuk bën durim për të, por menjëherë përgatitet kundra tij, thotë: “kjo ashpërsi është sikurse ashpërsia e haddadive”, dhe është e vërtetë që kjo gjë ndodh.

Kujdes – Allahu ju begatoftë – se mos këto

fjalë ia mveshni disa vëllezërve tanë selefi tek ju në Libi, si psh vëllaut tonë me vlerë Ebul Fadl el-Lijbi. Ai është burrë selefi, njeri me menhexh të shëndoshë sipas asaj që di unë. Prej tij kam parë, dhe kam dëgjuar nga shejhu ynë Rabia el Medkhali lëvdata që nuk i kam dëgjuar për shumë prej mësimdhënësve. Ai e ka cilësuar si mal, të qëndrueshëm gjatë fitneve (trazirave), se është selefi etj.

Sa i përket fjalës së shejh Ubejdit –Allahu e ruajtë – se fjala e vëllaut tonë Ebul Fadl nuk merret për personat [që flet] në Libi, kjo nuk është akuzë për Ebul Fadlin. Jini të vëmendshëm në tilla gjëra, sepse sikurse e dini ju, dijetarët e Xherhut dhe Ta’dilit janë të ndryshëm në lidhje me një person. Nganjëherë [dijetari] mund të thotë se filanin e ka kritikuar filani, mos e merrni kritikën e tij, sepse filani është i besueshëm tek ne; kjo mund të ndodhë. Kjo lloj kritike nuk është sikurse akuza për të kritikuarin që pohohet në librat e shkencës së Hadithit dhe terminologjisë së tij, kurrë; jini të vëmendshëm ndaj kësaj çështje. Kush e shfrytëzon fjalën e shejh Ubejdit për të akuzuar

vëllaun tonë Ebul Fadl, ai është prej kategorisë që unë po paralajmëroj prej tij, është prej atyre që mundohen të përçajnë selefitë, dhe është prej atyre që shfrytëzojnë disa qëndrime për interesa personale nën imazhin e mbrojtejes së MenhexhitSelefi. Jo pasha Allahun! Nuk dijmë rreth vëllaut tonë Ebul Fadl vetëm se të mirën, Sunetin dhe pasimin e tij. E lusim Allahun *azze ue xhel-le* që të rregullojë gjëndjen e atyre që janë penduar dhe kanë bërë publik kthimin e tyre nga disa gabime, se pasha

Allahun kthimi i tyre është më i dashur për ne sesa shumë gjëra, dhe më e dashur sesa akuza e tyre. E lusim Allahun që t'i bëjë të qëndrueshëm, t'i udhëzojë drejt të vërtetës, dhe secilit i merret dhe i kthehet fjala e tij.

Pra Allahu ju begatoftë, kjo vëllazëri Islame, dhe kjo dashamirsi mes vëllezërve selefi është diçka me rëndësi. E përsëris duke tërhequr vëmendjen, se me këto fjalë nuk kam për qëllim dashamirsinë me kundërshtarët që lodrojnë, nuk kam për qëllim me këto fjalë akuzimin e vëllezërve tanë selefi pasues të Menhexhit të

qartë Selefî, kurrë pasha Allahun; mirëpo sikurse dihet, Menhexhi Selefî është mesatar mes tolerimit, humbjes dhe mes ekstremizmit dhe ashpërsisë. E lus Allahun *azze ue xhel-le* që t'i bashkojë zemrat tona, ta rregullojë gjëndjen tonë dhe të më japë mua dhe ju singëritet në fjalë dhe vepra.

Poashtu prej çështjeve që dëshiroj të tërheq vëmendjen – Allahu ju begatoftë -, po i tërheq vëmendjen vetes dhe vëllezërve të mi në Libi rreth largimit nga përplasjet, largimit nga grindjet dhe largimit nga ndërhyrjet në punët që nuk ju përkasin, sepse Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* ka thënë:

“Nga Islami i mirë i një njeriu, është largimi nga ajo që nuk i përket.”
[Transmeton Tirmidhiu nga Ebu Hurejra, dhe e ka bërë Hasen]. Shumë prej problemeve – nëse reflektojmë rreth

tyre – do të gjejmë se prej shkaqeve të tyre është ndërhyrja e disave në çështje që nuk u përkasin, dhe nuk janë të aftë. Vërtetë ky person prish duke e menduar veten se po

ndreq. Largohuni – Allahu ju begatoftë – nga tilla punë, dhe stolisuni me edukatën Islame.

Poashtu prej çështjeve që porosis veten dhe ju – Allahu ju begatoftë – është edhe shtimi i veprave të mira, si leximi i Kuranit, falja e namazeve në kohën e tyre, mirësjellja ndaj prindërve, mirëbërja ndaj fukarenjve, jetimëve, nevojtarëve dhe vejushave. Vërtetë Selefizmi duhet t’u shfaqet njerëzve me tilla imazhe; sepse kjo është ajo në të cilën ka qënë Pejgamberi *sal- lAllahu alejhi ue sel-lem* dhe shokët e tij. Ata kanë qënë të kapur pas Menhexhit, e kanë praktikuar Islamin dhe i shtonin të mirat dhe adhurimet.

Poashtu ju këshilloj juve dhe veten për t’u larguar nga punët e ndaluara të cilat shkaktojnë ngurtësim të zemrës, dëshpërim dhe zymtje në fytyrë, shkaktojnë butësi në karakter dhe largim nga e vërteta; [të ndaluara si] mosrespektimi i prindërve, padrejtësia ndaj të tjerëve, përgojimi, bartja e fjalëve, dëmtimi i bashkëshortes, fëmijëve, fqinjëve, apo sjellja e keqe me dijetarët dhe vëllezërit selefi.

Këto – Allahu ju begatofte, ju bëfte të dobishëm dhe ju bashkofte – këto punë dhe këto porosi, pasha Allahun ato janë nga një vëlla dashamir i juaji, dhe nga një vëlla i kujdesshëm për ju, me leje prej Allahut. Nuk kam synuar me këto porosi vetëm se fytyrën e Allahut të Lartësuar.

E lus Allahun *azxe ue xhel-le* që mos të më privojë mua dhe as juve nga shpërblimi. [e lus] që të më bëjë mua dhe ju të qëndrueshëm në të vërtetë, dhe të më largojë mua dhe ju nga bidati, përçarja dhe kundërshtimet. [e lus] që të na bëjë prej njerëzve dashamirë, të mëshirshëm dhe të bashkuar.

E lus Allahun *azxe ue xhel-le* që t'i bëjë [këto fjalë] argument për ne dhe jo kundra nesh. Salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.